



Dr.ENKELEIDA LLESHI

Dr.Enkeleida Lleshi mbas mbarimit të shkollës së lartë pranë Institutit të Lartë Kulturës Fizike”Vojo Kushi” në vitin 1997, filloi të ushtroj profesionin e mësuesit të Edukimit Fizik në arsimin parauniversitar në Tiranë si dhe Trajnere Volejbolli. Në vazhdimësi të karrierës së saj në fushën e sportit të volejbollit arriti të kryej dhe të përfundoj kualifikimin në “Master i Nivelit të Dytë” Master Shkencor Specialitet “Volejbolli” pranë Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporte në vitin 2007 si dhe kualifikimin si Trajnere volejbolli pranë Federatës Shqiptare të Volejbollit në të njëjtin vit. Në vitin 2010 ajo është pranuar si punonjëse kërkimore shkencore në Departamentin e Kërkimit Lëvizor të Aplikuar pranë Institutin Kërkimor Shkencor të Sportit(IKSHS) në Universitetin Sporteve Tiranë. Në vazhdimësi ka kontribuar në fushën Fiziologjia e ushtrimit të aplikuar në sportin e volejbollit dhe në Shkurt të vitit 2016 ajo fitoi gradën shkencore “Doktor”. Dr.E.Lleshi vazhdon të jetë kerkuese shkencore në IKSHS si dhe drejtuese e Departamentit të Performancës Sportive në Universitetin e Sporteve Tiranë duke marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare si dhe botime në revista shkencore të ndryshme. Ajo ka kryer mësimdhënie pranë Fakulteteve të UST me përvojë 13 vjeçare. Interesi aktual është kërkimi shkencor që përputhet me nevojat e sporteve shqiptare dhe veçanërisht me lojtarët e volejbollit të grupeve të moshave të ndryshme, ku hulumtimi ka në thelb aplikimet e testeve specifike dhe orientime të seancave trajnuese në sportin e volejbollit.